

STATUTI I KONFEDERATËS SË SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË

(Miratuar në Kongresin e IV të KSSH, 24 Nëntor 2009)

KREU I PARË

Emri i organizatës

Neni 1

Emri i organizatës sindikale është: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, (KSSH), është krijuar dhe funksionon si bashkim vullnetar i Federatave Sindikale të profesioneve ose degëve të ekonomisë. KSSH-ja, është e njohur si Person Juridik me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.6/1, datë 3.09.1991. Mbledhja themeluese e saj është zhvilluar më 5 Qershor 1991. KSSH-ja, ndodhet me seli në adresën: Rruga “Barrikadave”, ish- kinema “17 Nëntori”, Kati 6, Tiranë.

Neni 2

Në bazë të bashkëvendosjes dhe ndarjes së përgjegjësisë KSSH-ja, përfaqëson ruajtjen e interesave ekonomike e sociale në të gjithë drejtimit e jetës shoqërore dhe publike, me qëllim arritjen e standardeve optimale të jetesës së anëtarëve të saj. Si një bashkim konfederativ, ajo ka si qëllim fuqizimin e lëvizjes sindikale në Shqipëri, për mbrojtjen e të drejtave, dinjitetit dhe interesave ekonomike e sociale të anëtarëve, nëpërmjet bashkërendimit të veprimit sindikal dhe të parimit të solidaritetit.

Parime të përgjithshme

Neni 3

KSSH-ja, është organizatë sindikale demokratike, e pavarur nga shteti, partite politike, grupimet fetare, punëdhënësit publik apo privat dhe nga organizatat e shoqatave e ndryshme joqeveritare.

Neni 4

KSSH-ja, në gjithë veprimtarinë dhe punën e saj udhëhiqet nga vullneti i përbashkët i anëtarëve të Federatave Sindikale, i Sindikatave të Profesionit, që janë anëtarë përbërës të saj. Veprimtarinë e vet ajo e bazon në këtë Statut, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Parimet Universale për Lirësi dhe të Drejtat e Njeriut, në strategjinë dhe objektivat e sindikalizmit evropian dhe botëror, pjesë e të cilës ajo është. Statuti i çdo Federate apo Sindikate Profesioni, që është njësi përbërëse e KSSH-së, duhet të jetë i unifikuar me këtë Statut.

Neni 5

KSSH-ja, zbaton me rigorozitet standardet dhe normat demokratike në ndërtimin dhe funksionimin e strukturave të saj dhe në zgjedhjen e organeve drejtuese.

Në forumet drejtuese dhe strukturat e KSSH-së, inkurajohet dhe mbështetet debati i hapur, respektohet mendimi ndryshe dhe vendimet merren në mënyrë demokratike.

Neni 6

Organet e zgjedhura të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë nga qendra në bazë janë Persona Juridik me Status Ligjor në të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Statuti i KSSH-së, Statutet e Federatave apo organizatave sindikale që përbëjnë KSSH-në, si dhe gjithë Legjislacionin Shqiptar dhe Konventat Ndërkombëtare të pranura nga Republika e Shqipërisë.

Organet drejtuese zgjidhen në mënyrë demokratike nga poshtë lartë, japin llogari para zgjedhësve dhe janë të revokueshme përpara tyre.

Neni 7

Anëtrësia e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë përbëhet nga anëtrësia e regjistruar në Federatat Sindikale apo Organizatat Qendrore Sindikale që përbëjnë KSSH-në.

Ne Organizatat Sindikale që përbëjnë Federatat e Sindikatave apo Sindikatat Qëndrore të Profesionit mund të anëtaresohet çdo i punësuar në sektorin publik ose privat, punonjes që janë në asistencë ose perkohësisht të papunë, emigrantet si dhe pensionistet, pavarësisht nga perkatesia partiake dhe bindjet politike ose fetare.

Antaresimi në Federatat Sindikale antare të KSSH-së, është vullnetar.

Te gjithë antaret e sindikates janë të barabartë pavarësisht nga nacionaliteti, gjinia, feja, ideja apo antaresimi partiak.

Neni 8

Sapo pranohet çdo anetar sindikate pajiset me kartën e anëtaresisë e cila përmban shenjen dalluese të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë dhe të Federatës perkatese, identitetin e numrin personal të antarit, emrin dhe seline e organizatës që e leshon.

Neni 9

Anetari që largohet nga sindikata është i detyruar të kthejë kartën e antaresisë. Kur kjo kartë humbet duhet të njoftohet Kryesia e Federatës perkatese e cila e shpall të pavlefshme atë.

Në rast largimi me dëshirë si dhe ripranimi në ndonjë sindikate tjetër anëtari që largohet duhet t'i shlyejë sindikates detyrimet (statutore) financiare deri në përfundim të vitit kalendarik.

Neni 10

Anëtaresia në organizatat sindikale vërtetohet në baze të regjistrimit themeltar të anëtarëve që hartohet nga çdo Federatë perkatese, Organizata Qëndrore e Profesionit, nga Seksionet e Profesionit dhe Seksionet Sindikale të Bazës, si dhe nga kërkesat e pranimit, deklaratimet e aderimit personal të çdo anëtari apo nga listat e anëtarësisë të nënshkruar nga secili anëtar. Në këtë rast lista duhet të ketë si shenjë dalluese (logo) Stëmën e Federatës në krahun e majtë dhe të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë në krahun e djathtë.

Qëllimi i organizatës

Neni 11

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ka për qëllim dhe mision kryesor të saj të hartojë, të udhëheqë dhe mbrojë politikën e lëvizjes sindikale në vend, posaçërisht në fushën e marrëdhënieve të punës, të pagave, të pensioneve, të përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës dhe të jetesës, sigurisë, përfshirë kërkesat dhe nevojat sociale, ekonomike dhe kulturore të sindikalisteve dhe punonjësve, të papunëve, pensionistëve, grave, të rinjve, invalidëve, etj.

Në përputhje me këtë mision KSSH-ja, ndërton marrëdhëniet me partneret ligjore sociale, me Qeverinë dhe punëdhënësit.

Neni 12

Për përmbushjen e misionit dhe të qëllimit kryesor të saj, KSSH-ja, synon dhe angazhohet posaçërisht për:

Ruajtjen dhe zhvillimin e një organizate Sindikale Kombëtare të fuqishme, të bashkuar, pluraliste, përfaqësuese dhe demokratike, të përberë nga Organizata Sindikale Profesionale të lira dhe demokratike, të afta për të ngritur dinjitetin e punës se denjë duke promovuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat dhe interesat e punëmarresve në nivel kombëtar dhe rajonal.

Neni 13

Të sigurojë solidaritetin dhe asistencën për sindikatat e profesioneve dhe ato rajonale e vendore.

Punësim të plotë dhe të zgjedhur lirisht, prosperitetin dhe standardizim me të mirë të jetesës për të gjithë anëtarët e saj, përfshirë sigurimin e pagave dhe të pensioneve, rregullimin e kohës së punës dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 14

Të garantojë integritetin e plotë të grave në organizatat sindikale dhe të promovojë në mënyrë aktive barazimin gjinor në strukturat e saj vendimmarrese në të gjitha nivelet.

Të mbështesë të drejtat e punëtorëve të rinj për punë të përshtatshme, edukim dhe trajnim, pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha nivelet vendimmarrese.

Të garantojë mbrojtjen dhe mbështetjen për të drejtat e punonjësve migrante dhe emigrante.

Neni 15

Të forcojë solidaritetin ndërmjet brezave brenda lëvizjes sindikale dhe të mbështesë të drejtat e punonjësve në pension për të ardhura të mjaftueshme.

Të kontribuojë për eliminimin e punës së detyruar si dhe të punës së femijeve.

Te luftoje perjashtimet sociale dhe nepermjet nxitjes se aksesit universal perkujdes shendetesor te pershtatshem dhe arsim baze te detyrueshem, per te siguruar cilesi ne sherbimet publike dhe te mesuarit gjate gjithe jetes.

Neni 16

Te ruaje dhe te zhvilloje bashkepunimin dhe bashkeveprimin me organizatat e tjera kombetare apo lokale si me ato qeveritare, joqeveritare etj; per te zhvilluar me tej politikat dhe aktivitetet e Konfederates ne avancimin e interesave te shoqerise si nje e tere.

Te siguroje nje legjislacion per marredheniet e punes demokratik dhe bashkekohor.

Te mbroje sindikalistet nga veprimet burokratike dhe arbitrare te punedhenesve shtetrorë ose privat.

Te forcoje solidaritetin nderkombetar me sindikatat dhe punonjesit e vendeve te ndryshme te botes.

Neni 17

Per arritjen e ketyre qellimeve KSSH-ja, perdor mjetet ligjore demokratike qe ka ne dispozicion dhe qe jane:

Negocimet dhe dialogu social.

Organizimi i takimeve, bisedave, mbledhjeve, mitingjeve, manifestimeve, protestave dhe demonstratave.

Aksioni sindikal perfshire greven e pjeseshme ose te pergjithëshme.

Manifestimet e solidaritetit per probleme jetike te vendit dhe kombit, per ruajtjen e lirise dhe pavaresise se atdheut, per denoncimin e veprimtarive antidemokratike e antipunetore.

Mbrojtja e këtyre parimeve bazë kërkon dhe përdorimin e të drejtës së rezistencës demokratike

Mbeshtetja e luftes dhe perpjekjeve te punonjesve te vendeve te ndryshme per liri, demokraci e progres shoqeror.

Neni 18

KSSH-ja, punon për demokratizimin e lëvizjes sindikale në vend, për sigurimin e një fryme te plote pluraliste e demokratike ne veprimtarine e sindikatave ne te gjithe nivelet.

KSSH-ja, zhvillon e forcon lidhjet me sindikatat e vendeve te ndryshme dhe institucionet e organizmat sindikale nderkombetare mbi bazen e parimit te solidaritetit dhe te interesit reciprok.

KSSH-ja, eshte anetare e Konfederates Nderkombetare te Sindikatave (ITUC), dhe bashkëpunim me synim anëtarësimin në Konfederaten Evropiane te Sindikatave, (ETUC), perfshire organizmat e tyre rajonale.

KREU I DYTE

Struktura organizative dhe formumet e KSSH-së.

Neni 19

Organi më i lartë i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, është Kongresi i saj. Ai analizon gjithë veprimtarinë e saj gjatë periudhës ndërmjet dy Kongreseve.

Kongresi përcakton programin dhe politikën e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë për të ardhmen.

Kongresi i KSSH-së, është organi më i lartë vendimmarrës. Ai mblidhet ne sesione te zakonshme nje here ne pese vjet.

Neni 20

Norma e përfaqësimit në Kongres është për çdo 200 anëtarë zgjidhet 1(një) delegat. Zgjedhja e delegatëve bëhet nga Kongreset e Federatave në përputhje me Statutin e KSSH-së, Statutet e Federatave, të Organizatave Qëndrore Sindikale si dhe të vendimeve të Asamblesë së KSSH-së.

Anëtarët e Asamblesë së KSSH-së, Presidentët e Federatave apo sindikatave Qëndrore të Profesioneve, Sekretarët Rajonal të Qarqeve dhe Rretheve, Koordinatorët e Rrjeteve të Gruas dhe Rinisë, Drejtori i Qendrës së Trajnimit dhe Studimeve Sindikale, Sekretari i Komisionit të Gjykimit Disiplinor, Sekretari i Komisionit të Statutit, Sekretari i Komisionit të Financës dhe të Auditimit, Përgjegjësi i Departamentit të Burimeve Njerëzore të KSSH-së, janë delegat të Kongresit sipas funksionit të tyre pa qenë nevoja të zgjidhen nga anëtarësia.

Neni 21

Mandati i delegatit është pesëvjeçar. Kongresi i fillon dhe i zhvillon punimet kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e delegatëve.

Me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Asamblesë së KSSH-së, thirret Kongresi ose Konferenca e Jashtëzakonshme e KSSH-së.

Kongresi ose Konferenca e Jashtëzakonshme kanë atributet e Kongresit të zakonshëm vetëm atëhere kur vendos Asambleja e KSSH-së me 2/3 e votave.

Neni 22

Kongresi i KSSH-së

Kongresi i Konfederates:

Degjon raportin e Presidenecës Ekzekutive të KSSH-së.

Miraton raportin e Presidenecës Ekzekutive të KSSH-së.

Diskuton, merr vendime dhe miraton rezoluta, ku percaktohen drejtimet themelore te politikës sindikale, nga njeri Kongres ne tjetrin.

Miraton Statutin e KSSH-se, si dhe ndryshimet e pemi-resimet qe i behen here pas here atij.

Miraton rezoluta per çeshtje te veçanta te levizjes sindikale.

Neni 23

Kongresi zgjedh Presidentin e KSSH-së, ne perputhje me Rregulloren qe vendos Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, per zhvillimin e Kongresit.

Miraton Asambleshën e Përgjithshme te KSSH-se, me kete perberje:

Presidentin e KSSH-së,

3 (tre) Zv/Presidentë të KSSH-së,

Sekretarin Organizativ të KSSH-së,

Presidentet e Federatave të Profesioneve anëtare të KSSH-së,

Sekretaret e Sindikatave Qendrore te Deges e Profesionit (nese ka te tilla).

Koordinatorët e Këshilleve Sindikal të Qarqeve,

Sekretarët Rajonal të Rretheve,

35 anetare nga radhet e Federatave sipas numrit te antaresise,

Koordinatorin e Rrjetit te Gruas,

Koordinatorin e Rrjetit te Rinisë,

Drejtorin e Qendrës së Trajnimit dhe Studimeve Sindikale,

Sekretarin e Komisionit të Gjykimit Disiplinor,

Sekretarin e Komisionit të Finances dhe Auditit,

Sekretarin e Komisionit të Statutit,

Pergjegjës in e Departamentit të Burimeve Njerëzore të KSSH-së

Anetaret e Asambleshë së Përgjithshme te KSSH-se, nga radhet e Federatave, qe i propozohen Kongresit te Konfederates per miratim, zgjidhen ne Kongreset e Federatave perkatese.

Neni 24

Kongresi miraton Komisionin e Finances dhe te Auditit të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Kongresi miraton Komisionin e Statutit të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Kongresi miraton Komisionin e Gjykimit Disiplinor të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 25

Vendimet dhe Rezolutat e Kongresit merren me shumicen e cilësuar të votave te delegateve pjesemarres, me perjashtim te rasteve kur Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, e percakton ndryshe.

Rendi i dites i Kongresit pergatitet nga Presidenca Ekzekutive dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, duke përfshirë aktivitetin dhe propozimet e Federatave, Sindikatave Qendrore, Sekretariateve të rretheve, Sindikatave të tjera vendore.

Data e thirrjes dhe Rendi i dites i Kongresit shpallen nga Presidenca Ekzekutive, në përputhje me vendimet që merr Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, por asnjehere jo më vonë se 45 ditë nga dita e zhvillimit të Kongresit të KSSH-së.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-se

Neni 26

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-se, eshte organi qe drejton dhe bashkerendon veprimtarine e Konfederates ne periudhen midis dy Kongreseve. Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, ka per detyre:

Te organizoje dhe drejtoje veprimtarine sindikale nepermjet perpunimit dhe zbatimit te politikave sindikale ne nivel kombetar.

Te koordinoje veprimtarine midis Federatave, Sindikatave Qendrore, Sekretariateve të rretheve dhe Sindikatave të tjera vendore dhe t'i mbeshtese ato per plotesimin e objektivave te tyre.

Te kontrolloje zbatimin e vendimeve te Kongresit ne te gjithe strukturat e KSSH-se.

Te shpalle e te organizoje levizje sindikale kombetare, perfshire manifestime, protesta dhe greva te pjeseshme ose te pergjitheshme. Vendimet per keto veprimtari merren me 2/3 e anetareve te Asamblesë.

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-se, mblidhet jo me pak se dy here ne vit.

Mbledhjet e Asamblesë së Pergjithshme të KSSH-së, drejtohen nga Presidenti, 3 (tre) zevendes Presidentët dhe Sekretari Organizativ i KSSH-së.

Neni 27

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, zgjedh 3 (tre) Zevendes Presidentë të KSSH-se, ku të paktën 1 (një) të jetë grua, nga radhet e Asamblesë së Pergjithshme të KSSH-së duke ruajtur normat e perfaqesimit.

Neni 28

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, vendos dhe shpall thirrjen e Kongresit të KSSH-së, percakton normat e perfaqesimit dhe menyren e zgjedhjes se delegateve, brenda kriterëve qe percaktohen ne kete Statut dhe ne Rregulloren e KSSH-se. Asambleja e Pergjithshme raporton para Kongresit per veprimtarine sindikale per periudhen nga Kongresi i mepareshm.

Neni 29

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, diskuton per raportet mbi veprimtarine e Presidencës Ekzekutive te KSSH-se, dhe i miraton ato me ndryshimet, plotesimet dhe permiresimet perkatese.

Diskuton per materialet, konkluzionet dhe vendimet, të cilat i paraqiten nga Komisioni i Statutit, Komisioni i Finances dhe Auditimit, Komisioni i Gjykimit Disiplinor, Qendra e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale dhe merr masat perkatese, sipas propozimeve qe i behen nga këto organe.

Neni 30

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, aprovon Buxhetin Vjetor te KSSH-se dhe bilancin vjetor te veprimtarise financiare, i cili paraqitet nga Presidenca Ekzekutive duke rakorduar me buxhetet dhe bilancet vjetore të Federatave, Sindikatave Qëndrore, Sekretariateve të Rretheve, dhe Sindikatave të tjera vendore dhe me Departamentin Ekonomik të KSSH-së. Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së percakton me rregullore parimet e administrimit te pronave të KSSH-se në cilësinë e pronarit.

Neni 31

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, miraton Rregulloren e Funkcionimit Organizativ të KSSH-se, dhe rregullat proceduriale per funksionimin e Asamblesë së Pergjithshme të KSSH-së, të Presidencës Ekzekutive te KSSH-se, dhe te organizmave te tjere qe mund te krijohen ne Konfederate me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të KSSH-së.

Neni 32

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, i propozon Kongresit per pranimin e Federatave, të Sindikatave Qëndrore në Nivel Profesionit, të cilat kërkojnë të jenë anëtare të KSSH-së, në përputhje të plotë me Vendimet e Strukturave Vendimarrëse të tyre dhe Statutin e KSSH-së.

Ne rast largimi te vullnetshem apo përjashtim të një strukture të KSSH, Asambleja vendos për riorganizimin e pjesës së mbetur në përputhje me statutin e KSSH.

Neni 33

Asambleja e Pergjithshme e KSSH-së, miraton me propozim të Presidencës Ekzekutive Rregulloren Elektorale, përfaqësinë e pregatitjes së Kongresit. Ajo vendos për zgjedhje të pjesëshme në strukturat e KSSH-së, kur bie votëbesimi, apo krijohen struktura të reja. Asambleja e Pergjithshme vendos për aleancat dhe lobingjet politike që mund të krijojë KSSH-ja, në dobi të saj.

Neni 34

Mbledhjet e Asamblesë së Pergjithshme jane te vlefshme kur ne to marrin pjese shumica e anetareve. Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme jane te zbatueshme kur per to votojne me shume se gjysma e anetareve te Asamblesë së Pergjithshme (dhe jo e te pranishmeve ne mbledhje). Perjashtim bejne shpallja e greves se pjeseshme ose te pergjitheshme dhe propozimi per pranimin ose largimin e Federatave, apo Sindikatave Qëndrore të Profesionit per te cilat duhet te shprehen ne favor me shume se 2/3 e anetareve te Asamblesë.

Neni 35

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me votim ose me konsensus. Vendimet merren pas debatit dhe shkëmbimit të lirë të mendimeve. Vendimet e miratuara me shumicë votash janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë strukturat e KSSH-së, të cilave u referohet vendimi. Pakica që ka votuar kundër, ka të drejtë të shfaqë pikëpamjet e saj në mbledhje si dhe të kërkojë rishqyrtimin e vendimit në strukturat që përcakton Statuti i KSSH-së. Vendimet të cilat për arsye të përligjura anulohen, i anulon vetëm Komisioni i Statutit pasi të bëjë përputhshmërinë e interpretimit të vendimit me Statutin apo rregulloret e KSSH-së.

Neni 36

PRESIDENCA EKZEKUTIVE E KSSH-SË

Presidenca Ekzekutive e KSSH-se, perbehet nga Presidenti, 3 (tre) Zevendes Presidencës, Sekretari Organizativ i KSSH-se, Kryetarët e të gjitha Federatave të cilat janë anëtare të KSSH-së, Drejtori i Qendrës së Trajnimit dhe Studimeve Sindikale, 4 (katër) Sekretar Rajonal Rrethesh, Koordinatorja e Rrjetit të Gruas, Koordinatori i Rrjetit të Rinjve. Presidencën Ekzekutive e miraton dhe e zgjedh Asambleja e Përgjithshme me propozim të Presidentit të KSSH-së.

Neni 37

Presidenca Ekzekutive e KSSH-se, drejton, organizon dhe ndjek veprimtarine per zbatimin e vendimeve te Kongresit dhe te Asamblesë së Përgjithshme te KSSH-se. Vendos per thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe pergatit materialet qe i paraqiten asaj.

Neni 38

Presidenca Ekzekutive e KSSH-së, organizon gjithë punen organizative, koordinuese dhe teknike të gjithë strukturave të KSSH-së, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të aktivitetit sindikal. Ajo ndjek planifikimin dhe zbatimin e strategjisë për kualifikimin dhe trajnimin e të gjithë anëtarësisë sindikaliste sipas programeve të caktuara nga Departamenti i Edukimit dhe Qendra e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale.

Neni 39

Presidenca Ekzekutive vendos për strukturën ekzekutive të administratës për të gjithë të punësuarit me kohë të plotë në të gjithë strukturat e KSSH-së. Diskuton dhe merr vendime për problemet që lidhen me mireadministrimin e pasurisë, përfshirë objektet dhe mjetet financiare, që posedon Konfederata. Ndjek zbatimin e buxhetit dhe të planeve ekonomike e financiare dhe raporton për to para Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-se.

Neni 40

Presidenca Ekzekutive, me propozim të Presidentit të KSSH-së, miraton numrin dhe emërimin e Koordinatorëve Rajonal te Qarqeve të cilët janë strukturë administrative e KSSH-së, dhe të punësuar me kohë të plotë dhe përgjegjës për koordinimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së strukturave të KSSH-së, në nivel Qarku apo Rajoni sipas detyrës që i kaktohet nga Presidenca Ekzekutive me një rregullore të veçantë.

Neni 41

Mbledhjet e Presidencës Ekzekutive drejtohen nga Presidenti i KSSH-së, përgatiten nga Sekretari Organizativ i KSSH-së. Presidenca Ekzekutive mblidhet si rregull një herë në tre muaj.

Me propozim të Presidentit të KSSH-së Presidenca Ekzekutive vendos për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, e cila do të zhvillohet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit të Presidencës Ekzekutive.

Neni 42

PRESIDENTI I KSSH-SË.

Presidenti i KSSH-se, është drejtuesi më i lartë në nivelin politik në KSSH. Ai është përgjegjësi kryesor për drejtimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së përditshme të KSSH-së, në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Forumet Drejtuese të KSSH-së.

Neni 43

Presidenti i KSSH-së, përfaqëson Konfederatën në veprimtaritë me institucionet shtetërore, partitë politike, organizatat shoqërore, sindikatat e tjera, me organizatat e punëdhënësve shtetërorë dhe privatë, me median, shoqërinë civile, etj., brenda dhe jashtë vendit.

Neni 44

Presidenti i KSSH-së, drejton dhe bashkërendon punën me Sekretariatën Ekzekutive dhe Presidencën e KSSH-së, nënshkruan në emër të KSSH-se marrëveshjet me Qeverinë, me institucionet e tjera shtetërore politikëbërëse dhe vendimmarrëse, me organizatat e punedhënësve, që veprojnë në shkallë kombëtare. Ai nënshkruan në emër të strukturave të KSSH-së, për të gjithë dokumentacionin shkresor dhe financiar të KSSH-se.

Neni 45

Presidenti i KSSH-së, mban qëndrim, merr vendime dhe ben deklarata e prononcime për çështje emergjente që nuk presin dhe vë në dijeni, në mbledhjen me të afert Presidencën Ekzekutive dhe Asamblesën e Përgjithëshme të KSSH-se. Ai ndjek zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të caktuara nga Presidencja Ekzekutive dhe Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-se.

Neni 46

Presidenti i KSSH-së, në përputhje me Ligjin dhe Statutin e KSSH-së, kryen funksionin e punedhësit për punonjësit që punësohen në strukturat e KSSH-se, në qendër dhe në qarqe. Ai në bashkëpunim me Sekretarin Organizativ drejton veprimtarinë dhe aktivitetet e përditshme të aparatit të KSSH-së. Ai në konsultim me Presidencën Ekzekutive sipas rastit, vendos për rangun dhe përberjen e delegacioneve që përfaqësojnë KSSH-në, në veprimtaritë ndërkombëtare si dhe për ftesat që i drejtohen KSSH-se, nga sindikatat simotra. Ai ndjek ecurinë e buxhetit dhe zbatimin e planeve ekonomike e financiare të Konfederatës dhe informon për të Sekretariatën Ekzekutive të KSSH-se. Presidenti i KSSH-së përfaqëson KSSH-në në Bordet me vendimarrje politike në strukturat shtetërore dhe kryeson Bordet që krijohen në Konfederatë në nivel qendror.

Neni 47

Në vendimarrjen e Presidencës Ekzekutive apo të Asamblesës së Përgjithëshme në rastet kur mungon konsensusi dhe kur votat në këto struktura ndahen në mënyrë të barabartë, fiton ai variant që ka mbështetjen e Presidentit të KSSH-se. Në mungesë të Presidentit të KSSH-së, këto funksione kryhen nga njëri Zv/president me prokurë nga Presidenti i KSSH-së, apo me Vendim të Presidencës Ekzekutive. Në rastet kur Presidenti i KSSH-se, lë detyrën për shkaqe të përligjura, pozicioni i tij nuk mund të vazhdojë pa u zëvendësuar me shume se 6 muaj. Brenda këtij afati, në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe Vendimin e Asamblesës së Përgjithëshme, thirret Kongresi i Jashtëzakonshëm, i cili zgjedh Presidentin e ri.

Neni 48

Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së, në mbledhjen e saj të parë pas Kongresit të Zakonshëm zgjedh tre Zv/presidentë dhe me propozim të Presidentit të KSSH-së, emëron Sekretarin Organizativ të KSSH-së, të cilët në përputhje me këtë Statut dhe me Rregulloren dhe Vendimet e Asamblesës së Përgjithëshme të KSSH-së, kryejnë detyrat e tyre funksionale në mbështetje të Presidencës Ekzekutive dhe në përputhje me detyrat që iu ngarkohen me Rregullore të veçantë nga Presidencja Ekzekutive apo me Prokurë të Posaëme nga Presidenti i KSSH-së.

KREU I TRETE

Federatat Sindikale dhe Organizatat Qëndrore Sindikale

Neni 49

Federatat Sindikale dhe Organizatat Qëndrore Sindikale, janë persona juridik, që me vullnet të lirë dhe në përputhje me vendimet e strukturave të tyre dhe Statutin e KSSH-së, kanë themeluar apo vazhdojnë të përbëjnë Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë, e cila është Person Juridik e rregjistruar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.6/1, me datë 03.09.1991, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, ish Kinema "17 Nëntori", K. VI, Tiranë.

Neni 50

Statuti i Federatave Sindikale apo i Organizatave Qëndrore Sindikale duhet të jetë i unifikuar dhe harmonizuar me Statutin e KSSH-së, në kuptimin që nuk mund të ketë kundërshtime midis tyre, përfshirë parimet, qëllimet, dhe funksionimin demokratik të organeve të zgjedhura, të drejtat dhe detyrimet ndaj bashkësisë Konfederative, etj. Anëtarësimi i Federatave apo i Organizatave Qëndrore Sindikale në Konfederatë, është shprehje e vullnetit të lirë të anëtarësisë sindikale e pasqyruar nëpërmjet vendimarrjes demokratike të strukturave të tyre. Anëtarësimi apo largimi i këtyre nga KSSH-ja, bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë Statut.

Neni 51

Me anetarsimin ne Konfederate, Federata Sindikale apo Organizata Qëndrore Sindikale ruan pavaresine dhe identitetin e saj dhe respekton identitetin dhe pavaresine e Federatave apo Organizatave Sindikale Qëndrore te tjera, veç e veç dhe te Konfederates ne teresi.

Neni 52

Per çeshtjet me thelbesore te bashkese konfederative, siç jane parimet e ndertimit te Konfederates, struktura organizative e saj, percaktimi i politikave per levizjen sindikale ne teresi, zgjedhja e organeve drejtuese ne te gjitha nivelet e KSSH-së, kuotizacioni dhe menyra e administrimit dhe perfitimit te pasurise qe disponon Konfederata, vendoset me konsensus. Në mungesë të arritjes së konsensusit vendimarrja merret me votim të cilësuar sipas rastit ne Kongres, Presidencën Ekzekutive apo Asamblenë e përgjithshme të KSSH-së.

Neni 53

Nje Bashkesi Organizatash Sindikale, Keshillash dhe Seksioneve Sindikale te nje dege ose profesioni, ne kuptimin e ketij Statuti, gezon statusin e Federates sindikale kur bashkon ne strukturat e veta jo me pak se 2000 anetare me kuotizacion, kur ka te anetaresuar 10-15 perqind te punesuar te deges ose profesionit dhe kur ka nje shperndarje gjeografike ne jo me pak se 50 perqind te rretheve sipas ndarjes administrative ne shkalle kombetare.

Neni 54

Bashkesite e Këshillave dhe Seksioneve Sindikale qe nuk plotesojne kushtet per te fituar statusin e nje Federate, konsiderohen Sindikata Qendrore te deges se ekonomise dhe profesionit. Ato bashkohen me Organizatat Sindikale të profesionit apo Federatat Sindikale me profesion të ngjashëm në KSSH, ose anetaresohen drejtperdrejt ne KSSH, me kusht qe ne KSSH te mos kete Federate te kesaj dege dhe profesioni. Këto vendime merren në Asamblenë e Përgjithshme të KSSH-së, duke respektuar Statutin e KSSH-së dhe vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës apo Organizatës Qëndrore Sindikale të Profesionit përkatëse.

Neni 55

Pranimi apo largimi i një Federate apo Organizate Qëndrore Sindikale behet vetem me vendim te Kongreseve te Zakonshme të tyre. Vendimi eshte i vlefshem kur per te kane votuar jo me pak se 2/3 e delegateve te Kongresit.

KREU I IV

Keshillat sindikale te rrethit dhe qarkut

Neni 56

Pranë çdo rrethi, distrikti prefekturë apo qarku në përputhje me Statutin e KSSH-së, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, ngrihen dhe funksionojne Keshillat Sindikale te rrethit, distriktit prefekturës apo qarkut. Këto Keshilla Sindikale përbëhen nga 1-3 perfaqesues te zgjedhur nga Seksionet Sindikale të Federatave apo Organizatave Qëndrore të Profesionit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda një territori administrativ të caktuar. Këshilli Sindikal zgjedh Sekretarin Rajonal të tij dhe një apo dy Zëvendës Sekretar, sipas rastit të përfaqësueshmërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së.

Neni 57

Keshilli Sindikal Vendor i Rrethit, Distriktit Prefekturës apo Qarkut funksionon në përputhje me ndarjen administrative shtetërore. Ai shqyrton dhe vendos per problemet me te rendesishme te levizjes sindikale ne këto njësi vendore, bashkerendon punen e Seksioneve Sindikale brenda njësisë së tij dhe i mbeshket ato. Ato ndjekin me perparesi punen per zbatimin e vendimeve dhe rezolutave te strukturave me te larta Federative dhe Konfederative. Këto Keshilla Sindikale janë organi i vetem qe ben analizen dhe vleresimin e veprimtarise sindikale në territorin e tyre.

Neni 58

Sekretariati i Këshillave Sindikale Vendore apo Rajonale te Rrethit, Distriktit Prefekturës apo Qarkut perbehet nga sekretarët e zgjedhur nga seksionet sindikale. Seksion Sindikal i Deges ose Profesionit perkates konsiderohet ajo strukture, e cila perfshine jo me pak se 3 keshilla sindikale te bazes me jo me pak se 15 anetare secili, ose edhe nje bashkesi te vetme sindikale ne rang ndermarrjeje, kompanie apo institucioni. Ne te dy rastet seksioni duhet te kete jo me pak se 50 anetare me kuotizacion.

Neni 59

Keshilli Sindikal i Rrethit, ngrihet kur ne perberje te tij funksionojne jo me pak se 5 Seksione sindikale qe perfaqesojne jo me pak se 400 anetare me kuotizacion te plote. Ne ato raste kur ne nje rreth nuk plotesohen kushtet statutore per ngritjen e keshillit sindikal te rrethit, seksionet sindikale qe funksionojne ne kete rreth lidhen drejtpdrejtë me KS te Qarkut. Mbledhjet e Këshillit Sindikal te Rrethit pergatiten nga sekretariati e tij dhe drejtohen nga Sekretari dhe zv/sekretari. Keshilli Sindikal i Rrethit mblidhet jo me pak se tre here ne vit, ndersa Sekretariati i tij nje here ne 3 (tre) muaj. Në Sekretariat bëjnë pjesë Sekretarët e Seksioneve Sindikale.

Neni 60

Keshilli Sindikal i strukturës vendore rajonale, Rreth, Distrikt Prefekturë apo Qark, kur e gjykon te arsyeshme dhe te nevojshme mund te organizoje edhe takime, tryeza ose konferenca me aktivin e zgjedhur, per te diskutuar probleme madhore te levizjes sindikale ne territorin ku ushtron aktivitetet ose më gjerë. Keshilli Sindikal i Qarkut perbehet nga Sekretarët e Këshillave Sindikale te rretheve dhe nga Sekretarët e Seksioneve Sindikale, qe perbejne qarkun.

Neni 61

Keshilli Sindikal i Qarkut, është një strukturë konsultative e cila drejtohet nga Koordinatori Rajonal i KSSH-së për Qarkun përkatës. Ky koordinator përzgjidhet nga Presidenca Ekzekutive me propozim të Presidentit të KSSH-së. Koordinatori Rajonal është funksionari përgjegjës për koordinimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së strukturave Konfederative në nivel Qarku. Numri, detyrat dhe funksioni i Koordinatorëve Rajonal përcatohet me vendim të veçantë nga Presidenca Ekzekutive e KSSH-së. Koordinatori Rajonal harmonizon dhe mbeshket punen e KS te rretheve dhe te seksioneve sindikale dhe organizon e drejton punen per zbatimin e detyrave dhe te vendimeve te organeve drejtuese te KSSH-se, para te cilave ai pergjigjet.

Neni 62

Keshilli Sindikal i Rrethit, Distriktit, Prefekturës apo Qarkut ndjek ne menyre operative mbarevajtjen, organizimin dhe funksionimin e gjithe levizjes sindikale si dhe pergjigjet per trainimin dhe rekrutimin e anetareve te rinj ne gjithe territorin e qarkut.

Sekretari i rrethit, apo rajonit, ka detyrë funksionale grumbullimin dhe administrimin e kuotave të anëtarësisë në përputhje me statutin dhe rregulloret e KSSH.

Keshillat Sindikale te Rrethit, Distriktit, Prefekturës apo Qarkut koordinojne punen dhe mbajne lidhje te vazhdueshme me KSSH-ne, dhe Federatat perkatese duke ndjekur dhe zbatuar udhezimet dhe vendimet e tyre. Mbledhjet e tyre drejtohen nga Sekretari dhe Zv/Sekretari, ndërsa për Qarkun nga Koordinatori Rajonal i KSSH-së për Qarkun përkatës. Keshilli Sindikal i Rrethit, Distriktit, Prefekturës, Qarkut, mblidhet jo me pak se 4 (katër) here ne vit.

Rrjeti i Grave dhe Rrjeti i të Rinjve

Neni 63

Prane KSSH-se funksionojne Rrjeti i Gave dhe Rrjeti i të Rinjeve. Keto Rrjete nuk kane karakter vendimarrës, por përfaqësojnë interesat e grave dhe të rinjve si grupe interesi specifike në fushat ekonomike, sociale, profesionale, kulturore, shëndetësore, sportive, arsimore, edukative, të punësimit, të shpërblimit, etj. Në të gjithë strukturat drejtuese të KSSH-së, që nga niveli i bazës deri në piramidë 30% e të zgjedhurve duhet të jenë gra dhe po 30% e të zgjedhurve duhet të jenë të rinj (deri 35 vjeç).

Këto rrjete funksionojnë me Rregullore përkatëse të miratuara nga Asambleja e KSSH-së, në përputhje me këtë Statut.

KREU V

Komisioni i Statutit

Neni 64

Per te interpretuar dhe zbatuar drejt Statutin, per te zgjidhur ne menyre demokratike mosmarrveshjet vepron Komisioni i Statutit. Ai perbehet nga pese anetarë. Çdo anetar i ketij komisioni duhet te kete vjetersi ne sindikate mbi 5 vjet. Mundesisht te jene eksperte dhe me reputacion ne sindikate.

Ky komision kryen studime dhe konsultime per permiresimet e nevojshme ne Statut dhe i nxjerr rekomandime e propozime Kongresit. Ai vendos mbi konfliktet qe i perkasin interpretimit te Statutit. Kontrollohen direktivat dhe vendimet e strukturave per perputhshmerine me statutin.

Neni 65

Komisioni i Statutit ushtron kontroll ne te gjitha forumet dhe strukturat e KSSH-së, në te gjitha nivelet per zgjidhjen e kerkesave e ankesave te antareve dhe zbatueshmerine e plote statutore.

Neni 66

Njerin nga anetaret e vet ky komision e zgjedh kryetar te ketij komisioni.

Çdo anëtar i ketij komisioni nuk duhet te kete lidhje direkte me analizat e gjykimit ne fjale si individ apo sindikaten qe perfaqeson.

Neni 67

Komisioni raporton ne çdo 2 vjet ne Presidencen Ekzekutive te KSSH-se ndersa ne Kongres raporton per aktivitetin e gjithë mandatit te tij. Anetaret e komisionit japin llogari para anetareve te sindikates dhe forumeve qe i ka zgjedhur.

Komisioni i gjykimit disiplinor

Neni 68

Kongresi i rregullt i KSSH-se, zgjedh Komisionin e Gjykimit disiplinor. Ai perbehet nga pese anetar. Çdo anetar i ketij Komisioni duhet te kete vjetersi ne sindikate mbi tre vjet. Anetaret e ketij komisioni duhet te jene te zgjedhur ne strukturat kombetare te Sindikates. Ky Komision ka per detyre te zgjidh demokratikisht mosmarreshjet ne perputhje me Statutin e KSSH-se, dhe ligjshmerine e Shtetit Shqiptar dhe per te gjykuar dhe ndeshkuar ata anetar qe shkelin Statutin, Rregulloren, apo vendime te tjera te miratuara nga stukturat vendimmarrese te KSSH-se.

Neni 69

Çdo anetar i ketij Komisioni nuk duhet te kete lidhje direkte me analizat e gjykimit ne fjale si individ, apo sindikaten qe perfaqeson. Ne kete rast anetari qe ka lidhje direkte me individin apo sindikaten qe diskutohet apo gjykohet, neutralizohet perkohesisht nga Komisioni.

Ky Komision merr keto masa:

Ben shfajesimin e anetarit apo sindikates se akuzuar.

Nxjerre verejtje te shkruar.

Pezullon sindikalistet e zgjedhur per periudha te kufizuara nga funksionet sindikaliste si dhe nga delegacionet e sindikates.

Perjashton nga sindikata sindikalistet qe kane bere thyerje te renda te ketij statuti.

Ne rastet kur shkeljet perbejne veper penale ky komision i sugjeron Kryetarit te KSSH-se, per t'iu drejtuar organeve te drejtesise.

Neni 70

Komisioni i gjykimit disiplinor vendimet i merr me shkrim dhe ua paraqet paleve te interesuara dhe Asamblese se Pergjithshme te KSSH-se, e cila ne mbledhjen e radhes diskuton dhe vendos per to. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te KSSH-se, eshte i formes se prere. Megjithate, i fajesuari ka te drejte t'i drejtohet Kongresit, vendimi i te cilit eshte perfundimatar.

Komisioni i Finances dhe Auditimit

Neni 71

Kongresi i rregullt i KSSH-se, zgjedh Komisionin e Finances dhe Auditimit prej pese vetash per te ndjekur dhe kontrolluar problemet financiare ne te gjithë strukturat e KSSH-se. Ky Komision zgjedh nje Sekretar dhe nje Zv. Sekretar. Komisioni i Finances dhe Auditimit te KSSH-se eshte i detyruar te revizionoje dhe çertifikojë vet ose me ekspert llogarite e bilancet vjetore te KSSH-se.

Neni 72

Komisioni i Finances dhe Auditimit ka per detyre qe ne vijueshmeri te kontrolloje zbatimin e buxhetit, perdorimin e drejte dhe ne perputhje me Statutin e Legjislacionin ne fuqi te mjeteve financiare e monetare, miremenaxhimin e pasurise se Sindikates. Ky Komision bashkepunon me Komisionet perkatese te Federatave dhe me Presidencen Ekzekutive te KSSH-se, duke shkëmbyer informacione dhe duke dhene rekomandime, e marre vendime, ne zbatim te Statutit, Rregulloreve e Vendimeve te Strukturave Vendimmarrese te KSSH-se.

Neni 73

E gjithë veprimtaria e ketij Komisioni mbahet e dokumentuar me shkrim, mbledhjet dhe vendimet e tij, pasqyrohen me proces-verbal me shkrim, ku nje kopje dergohet ne Presidencen Ekzekutive te KSSH-se. Ky Komision raporton nje here ne vit ne Asamblene e Pergjithshme dhe ne Kongresin e radhes raporton per aktivitetin e tij gjate gjithë mandatit. Anetaret e ketij Komisioni japin llogari perpara strukturave vendimmarrese te KSSH-se, por jane te revokueshem vetem nga forumi qe i ka zgjedhur.

KREU VI BURIMET FINANCIARE TE KSSH-SE

Neni 74

KSSH-ja, siguron te ardhurat e saj financiare nga pjesa e kontributit qe derdh çdo Federate nga kuotat e anetaresise, si dhe nga venia ne shfrytezim e perdorimi ne perputhje me ligjin i pasurise dhe objekteve ekonomike qe gezon me Ligj Konfederata.

Neni 75

Kuota e anetaresise per çdo Federate, apo Organizate Qendrore Sindikale, anetare te KSSH-se, vendoset nga Strukturat e tyre vendimmarrese. Ajo nuk mund te jete me pak se eshte 05 % dhe me shume se 1% e pages mujore neto per çdo anetar. Perjashtim ben Federata e Pensionisteve, e cila paguan jo me pak se 10 leke ne muaj.

Neni 76

Te ardhurat nga kuotazicioni mblidhen si rregull i përgjithshëm ne rrugë bankare, me numër llogarie në bankë në njesinë territoriale (rreth, qark) dhe pastaj në përputhje me statutin dhe rregulloren financiare të Asamblesë së KSSH shkojnë në destinacionin e perdorimit të tyre sipas ndarjes si me poshte:

1. 35 % të kuotave Sindikata territoriale
2. 40 % Sindikata qendrore e profesionit (federata)
3. 20 % KSSH
4. 5 % KSSH, fondi i edukimit dhe kualifikimit, i cili grumbullohet ne KSSH

Mos pagesa me 6 muaj rrjesht e çdo antari te kuotes sindikaliste, e pushon qenien e tij si anëtar sindikate.

Neni 77

Pronari i mjeteve monetare dhe i pasurise se luajtshme e te paluajtshme qe KSSH-ja, ka trasheguar ose fituar me ligj dhe me çdo forme tjeter qe njeh Kodi Civil i Republikes se Shqiperise, eshte Asambleja e Pergjithshme e KSSH-se. Presidenca Ekzekutive e KSSH-se eshte administratori dhe menaxhuesi i kesaj pasurie. Me propozim te Presidences Ekzekutive te KSSH-së, Asambleja e Pergjithshme e Konfederates, miraton Rregulloren per administrimin dhe menaxhimin e perditshem te pasurise.

Neni 78

Te ardhurat qe realizohen nga venia ne shfrytezim e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme te KSSH-se, perqendrohen ne nje qender te vetme ekonomike, ne Departamentin Ekonomik te KSSH-se. Asambleja e Pergjithshme e KSSH-se, ne fillim te çdo viti, krahas miratimit te Buxhetit te Konfederates, miraton edhe kriteret e shperndarjes se ketyre te ardhurave, perfshire perqindjen qe do te mbaje Konfederata, perqindjen qe do te perfitojne Federatat, Organizatat Qendrore Sindikale, Strukturat Rajonale, (Rreth, Qark, Distrikt) sipas aktivitetit sindikal dhe mundesise reale te financimit te tyre. Kryesisht perqindja e te ardhurave shperndahet ne perpjestim me numrin e anetaresise me kuotizacion. Asambleja e Pergjithshme vendos dhe krijon Fondin Rezerve, i cili perdoret vetem me miratim te kesaj Asambleje.

KREU VII

Mospranimi dhe pacenueshmeria e zgjedhjeve

Neni 79

Zgjedhjet mund te kundershohet brenda 10 diteve nga data e kryerjes se tyre. Deklarimi i mospranimit te tyre duhet te behet me shkrim duke treguar qarte dhe argumentuar arsyet e kundershimit. Te autorizuar per te kundershuar nje zgjedhje apo mbledhje jane: 1/3 e njerezve te lejuar per te votuar ne zgjedhjen qe eshte kundershuar. I deleguari per te ndjekur zgjedhjen ose anetari i Asamblese se Pergjithshme te njesise qendrore, i cili eshte i mandatuar nga rajoni ku kryhet zgjedhja.

Neni 80

Mospranimi i nje zgjedhje duhet te lejohet nese nje e mete qe eshte konstatuar ka ndikuar direkt ne rezultatin e zgjedhjes. Organi me i larte statutor brenda 10 diteve merr vendimin dhe kthen pergjigjje me shkrim te ankesave per vlefshmerine e zgjedhjeve.

Në rast se një organizatë sindikale, Këshill sindikal rrethi, sindikatë qendrore profesioni apo federate sindikale ka zhvilluar një veprimtari të kontestueshme (nga zgjedhja deri tek kuotazicioni) të papranueshme nga statuti apo rregulloret e miratuara të

KSSH, Asambleja e KSSH merr vendime për anulimin dhe vendos për të kryer deri në rizgjedhje apo riorganizim të kësaj strukture kur ka pasoja në lëvizjen sindikale.

KREU VIII

DISPOZITA TE VEÇANTA

Neni 81

Ne te gjithë strukturat e KSSH-se, Konfederative, Federative, Profesionale, Rajonale e Vendore, Organet drejtuese zgjidhen ne menyre demokratike nga poshte lart, japin llogari para zgjedhesve dhe jane te revokueshem prej tyre.

Neni 82

Mandati i Drejtuesit politik eshte i papjtueshem me funksionin e drejtuesit te Partive Politike, te Shoqatave e Organizatave te ndryshme fitimpruresse e jo fitimpruresse qe kryejne veprimtari publike e private si dhe te drejtuesit te institucioneve fetare. Me funksionet drejtuese qeveritare apo te drejtueseve te pushtetit vendor si Kryetar Komune, Bashkie, Qarku, Prefektura, Distrikti, Drejtor Drejtorie ne te gjitha strukturat e pushtetit vendor e qendror. Eshte i papjtueshem me funksionet e punedhensesit apo te perfaqesueseit ligjor te tij te percaktuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 83

Mandati i drejtuesit Politik eshte i papjtueshem (humbet e drejta për ta fituar) kur gjysma e pare e ketij mandati korrespondon me afatin ligjor te mbushjes se moshes per pension. Ky mandat per strukturat vendore (Kryetar rrethi, e Sekretar Organizate sindikale eshte i papajtueshem kur perfituesi i mandatis nuk eshte me vendbanim ligjor te perhershem apo me pune te perhereshme ne teritorin, njesine administrative apo ndermarrjen qe e mandaton.

Neni 84

Manadi i drejtuesit politik ne nivel rrethi, federate e konfederate është i pajtueshem me funksionin e deputetit, gjyqtarit, avokatit, anetarit te Këshillave të Qarqeve, rretheve, bashkive, Komunave, e te bordeve te ndryshme drejtuese e menaxhuese ne te gjitha nivelet.

Neni 85

Të zgjedhurit per te perfituar mandatis politike ne nivel qendror (Vendin e Presidentit te KSSH-së, dhe Presidentit te Federates duhet te jene anetar te organizmave drejtuese te Konfederates, Federatave ose Keshillave sindikale te rretheve. Qënia e tyre delegat ne strukturen qe e zgjedh dhe pranimi me vullneti te lire i kandididimit jene te domosdoshme.

Neni 86

Drejtuesite zgjedhur Sindikal qe jane ne marredhenie pune ne ndermarrje apo institucione publike e private nuk mund te levizin nga puna qe kryejne pa marre me pare pelqimin e Sindikates qe i ka zgjedhur.

Veprimtaria Botuese

Neni 87

KSSH-se boton organin e saj periodik te shtypit, qe eshte Gazeta "Pasqyra". Me vendim te Presidences Ekzekutive mund te botohen edhe organe te tjera shtypi, buletine, panflete, pankarta, reklama, etj; ne shtypin e perditshem, apo ne mediat audio vizive.

Neni 88

Ne zbatim te ketij Statuti Asambleja e Pergjithshme e KSSH-se, miraton Rregullore dhe vendime te veçanta ne perputhje me propozimet e Presidences Ekzekutive.

Pushimi i ekzistences se KSSH-se (shperndarja)

Neni 89

KSSH-ja pushon se ekzistuari ne baze te kritereve qe percakton neni i KC dhe ne menyre me konkrete kur:

- a. Nuk kryen misionin per te cilin eshte krijuar.
- b. Me vendim te Kongresit te zakonshem shkrihet ose bashkohet me organizma te tjere sindikale brenda vendit.
- c. Zvogelohet numri i Federatave nen minimumin qe kerkon ligji dhe percakton ky Statut per krijimin e nje Konfederate.

d. Ka nje vendim gjyqesor te formes se prere per shperndarjen e saj.

Neni 90

KSSH-ja, ka Statutin, programin, flamurin, emblemen dhe vulen e saj qe jane me tre ngjyra; te kuqe, te zeze dhe jeshile. Federatat apo organizatat qendrore sindikale anetare te KSSH-se, kane edhe ato flamurin, emblemen dhe vulen e tyre, si dhe Statutin dhe programin e tyre te unifikuar dhe integruar ne frymen e Statutit dhe programit te KSSH-se. Të drejten e perdorimit te simboleve te KSSH-së, e kane vetem institucionet qe perfaesojne KSSH-në, ne nivel qendror e vendor.

Neni 91

Statuti ka marr fuqi ligjore per t'u zbatuar qe nga data 24 Nentor 2009, pas miratimit te tij ne Kongresin e IV te Konfederates se Sindikatave te Shqiperise.

Struktura Organizative e KSSH

Miratuar ne Kongresin e IV te KSSH me 24 Nentor 2009, votuar si pjese e Statutit te KSSH.

1. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Arsimit dhe Edukimit dhe Shkences

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Arsimit Parashkollor (public dhe privat)
- Sindikata e Arsimit te Detyruar 9- vjecar (public dhe privat)
- Sindikata e Arsimit te Mesem te Pergjithshem e Profesional (public dhe privat)
- Sindikata e Arsimit te Larte dhe Institucioneve Arsimore Kerkimore e Shkencore (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjesve te sektoreve ndihmes te sistemit arsimor

2. Federata e Sindikatave te Punonjsve te Industrise se Shqiperise

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Punonjesve te Elektro-Energjitikes (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjsve te Industrise nxjerrre dhe perpunuese te mineraleve metalore dhe jo metalore.
- Sindikata e Punonjesve te naftes dhe gazit (nxjerrje, perpunim, tregtim) (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjesve te Industrise se lehte metal-mekanike, prodhuese dhe perpunuese.
- Sindikata e Punonjesve te teknologjise informatike dhe te rrymave te dohta.

3. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Sherbimit Civil dhe te Administrates Shteterore.

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Punonjesve te Administrates shteterore (vendore dhe qendrore)
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit Publik dhe Sherbimit Civil
- Sindikata e Punonjesve Civil te Mbrojtjes, Rendit dhe SHIK-ut (pa uniformed he pa armatim)
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit te Avokatise dhe Jurisprudences

4. Federata e Sindikatave te Shendetesise te Shqiperise

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Punonjesve ne sherbimin spitalor dhe ambulator (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit paresor
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit Stomatologjik
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit Farmaceutik
- Sindikata e Punonjesve te Sherbimit te infrastructures shendetesore (urgjenca, lavanteri, guzhina, administrate, etj)

5. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Transportit dhe Telekomunikacionit

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Punonjesve te transportit Rrugor dhe Infrastruktures lidhese e tyre (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjesve te Transportit hekurudhor
- Sindikata e Punonjesve te transportit detar dhe ajror
- Sindikata e Punonjesve te sherbimit postar (public dhe privat)
- Sindikata e Punonjesve te sherbimit te telefonise fikse dhe telefonise celulare dhe sherbimeve perkatese te tyre.

6. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Ndertimit, Drurit dhe Infrastruktures Publike

Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:

- Sindikata e Punonjesve te Infrastruktures se sherbimit publik (ujesjelles, pastrim, gjelberim, kuartalla, vepra arti, etj)

- Sindikata e Punonjesve te Ndertimit
 - Sindikata e Punonjesve te Perpunimit te Drurit
 - Sindikata e Punonjesve te Prodhimit te Materialeve te Ndertimit (cimento, tulla, pllaka, gelqere, allci)
 - Sindikata e Punonjesve te Letres dhe Tipografise
- 7. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Tekstilit, Konfeksioneve dhe Sherbimeve Artizanale
Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:**
- Sindikata e Punonjesve te Tekstilit
 - Sindikata e Punonjesve te Konfeksioneve
 - Sindikata e Punonjesve te Lekure kepuces
 - Sindikata e Punonjesve te Sherbimeve Artizanale (berber, parukier, rrobaqepes, kepuhari, ngjyrosje, etj)
- 8. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Bujqesise, Ushqimit, Pylltarise dhe Ambientit
Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:**
- Sindikata e Punonjesve te Bujqesise
 - Sindikata e Punonjesve te Pylltarise dhe te Ambientit
 - Sindikata e Punonjesve te Faunes dhe Blegtorise
 - Sindikata e Punonjesve te Peshkimit
 - Sindikata e Punonjesve te Prodhimit dhe Perpunimit te Industrise agro-ushqimore
- 9. Federata e Sindikatave te Sherbimit Policor
Kjo Federate do te perfshije punonjesit e Sindikatave si vijon:**
- Sindikata e Punonjesve te Policise se Rendit
 - Sindikata e Punonjesve te Policise se Burgjeve
 - Sindikata e Punonjesve te Policise Bashkiake
 - Sindikata e Punonjesve te Policise Zjarrfikese
 - Sindikata e Punonjesve te Sigurise (Policia e sigurise private te objekteve, personave, VIP-ave, etj)
- 10. Federata e Sindikatave te Pensionistev dhe te Papuneve
Kjo Federate do te perfshije pensionistet te organizuar ne Sindikata si vijon dhe te papunet:**
- Sindikata e Pensionistev Intelektuale
 - Sindikata e Pensionistev Ushtarake
 - Sindikata e Pensionistev te Profesioneve te tjera
 - Sindikata e e te papuneve
- 11. Federata e Sindikatave te Sherbimeve Financiare, Tregtare, Bankare dhe Turizmit.
Kjo Federate do te perfshije te gjithe punonjesit e Sindikatave si vijon:**
- Sindikata e Punonjesve te Tregtise (shumice dhe pakice)
 - Sindikata e Punonjesve te Turizmit (hoteleri, restorante, agjenci)
 - Sindikata e Punonjesve te Turizmit dhe Sistemit Bankar
 - Sindikata e Punonjesve te Sistemit te Sigurimeve dhe Siguracioneve
- 12. Federata e Sindikatave te Punonjesve te Shtypit, Medias, Kultures dhe Sportit
Kjo Federate do te perfshije te gjithe punonjesit e Sindikatave si vijon:**
- Sindikata e Punonjesve te Gazetarise
 - Sindikata e Punonjesve te Medias Autovizive
 - Sindikata e Punonjesve te Institucioneve Kulturore dhe Sportive

